

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

ARIAN KRASNIQI

DRAMATURGJIA E RE E KOSOVËS

1. Hyrje

Një nga gjinitë kryesore të letërsisë artistike, mbase edhe më e vjetra, është drama. Në pjesën më të madhe veprat dramatike shkruhen dhe janë të destinuara për t'u shfaqur në teatër. Është i njohur fakti se origjina e artit dramatik nuk mund të kërkohej vetëm në një vend dhe vetëm te një popull, sepse historia mijëvjeçare e shkrimit dhe inskenimit të dramës përfshin një kontekst më të gjerë historik, gjeografik, social dhe kulturor.

Për dallim prej vendeve tjera, në Kosovë, fillet, formësimi dhe zhvillimi i dramës dhe teatrit, historikisht, është dukshëm më i vonshëm. Kështu që, historia e shkrimit të dramës dhe formimit të teatrit si institucion, është e re dhe si kohë shënohet me periudhën e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (1944).

Ky punim mëton që të evidentojë autorë dhe të analizojë vepra dramatike të dramaturgjisë së re në Kosovë, kryesisht asaj pas vitit 2000, në shumë dimensione: ideore, tematike, strukturore dhe stilistike. Kjo dramaturgji a po e shënon shkëputjen përfundimtare nga tradita e shkrimit të dramës shqipe apo ende mbetet nën hijen e traditës së shkrimit të dramës në Kosovë? Kësaj dhe shumë pyetjeve tjera synohet t'u jepet përgjigje përmes këtij punimi.

2. Drama e (mbas)luftës

Vitet e pasluftës, bashkë me lirinë, i sollën Kosovës edhe kushte dhe mundësi më të mira për organizimin, zhvillimin dhe promovimin e teatrit dhe dramës. Fill me të mbaruar lufta, më 1999, Teatri Kombëtar i Kosovës (TKK) zgjodhi që në krye të kalendarit të tij artistik ta vendos një nga kryeveprat e dramaturgjisë botërore: "Hamletin" të William Shakespeare, me regjisor anglezin David Gothard.

"Hamleti" u realizua si një spektakël që ngre para publikut shqiptar dilemën për hakmarrje. Njëri nga aktorët e shfaqjes, në një mezoskenë, i rrëfen publikut ndodhinë e tij personale. Gjatë luftës ai ishte rrëmbyer nga ushtarë serbë. Ata pasi e kanë rrahur i kanë atij kërkuar të deklamojë diçka nga Shekspiri. Aktori ka zgjedhur monologun "Të jesh apo të mos jesh" nga Hamleti, dilemë kjo, që gjithsesi në ato momente ka korresponduar me dilemën e tij: a do të vdes apo do të mbetet i gjallë!"¹

Vënia në skenë e kësaj shfaqjeje, me të mbaruar lufta, u pa si një parashenjë e një fryme dhe një tendence për zhvillimet e mëpastajme teatrore dhe dramaturgjike shqipe në Kosovë, ku bukur shpesh, edhe sot, dramat dhe shfaqjet

¹ J. Neziraj, *Teatri në Kosovë, sfidat në shtetin e ri* në "Teatri dhe Nacionalizmi", Prishtinë, 2011, f. 178.

që kanë për temë luftën anojnë kah teatri dokumentar, *ku përmes patosit evokohen kujtime nga lufta*.

Në dhjetëvjetëshin e fundit, drama dhe teatri në Kosovë nuk janë zhvilluar jashtë kontekstit të gjithëmbarshtëm politik dhe socio-kulturor të vendit tonë.

Sa i përket prezencës së dramaturgjisë shqipe në skenat e teatrore në Kosovë, një vështrim i lehtë mbi përmbajtjet e programeve artistike të teatrove publike në Kosovën e pasluftës, na i nxjerr në pah emrat e autorëve shqiptarë, veprat e të cilëve janë vënë në skenë, emra këta që kryesisht i takojnë gjysmës së dytë të shekullit '20, të cilët ndër vite janë identifikuar si autoritete krijuese letrare.

Tekstet dramatike të autorëve: Anton Pashku, Ymer Shkreli, Azem Shkreli, Teki Dervishi, Beqir Musliu, Mehmet Kraja, Rexhep Qosja, etj. e deri te dramatizimet e romaneve të Ismail Kadarese janë inskenuar në skenat e teatrove publikë, në disa raste më shumë se dy herë. Ani pse *këto drama ngriheshin mbi modelin strukturor të dramës skematike*², kjo përzgjedhje e këtyre autorëve nga drejtuesit e teatrove përkon me mbizotërimin e idesë për mungesën e një dramaturgie të re shqipe në Kosovë dhe për nevojën e orientimit programor artistik që e kthen teatrin tonë kah tradita, pra te dramaturgjia e cila në përmbajtjen e vet tematike lidhet me aspekte dhe ngjarje të veçanta të historisë sonë, duke krijuar, kështu, përfytyrimin e një tradite të dramaturgjisë shqipe që shpreh më së miri identitetin tonë kombëtar edhe kulturor.

Edhe pse është konsideruar se *në fillim të shekullit 21 drama shqiptare në tërë hapësirën etnike është çlirur plotësisht nga të gjitha ngarkesat paraprake duke marrë fizionominë dhe strukturën bashkëkohore moderne si dramaturgjia e përgjithshme evropiane*³ Megjithëse, simbas disa vlerësimeve përgjithësisht, *kjo gjeneratë dramaturgësh vazhdon të krijojë mbi konturat e një tradite të formësuar, poetika e të cilës, përkundër disa prirjeve, tendencave dhe përjashtimeve individuale, kryesisht vazhdon të identifikohet me dorëshkrimin e traditës letrare të gjysmës së dytë të shekullit 20*.⁴

Në kontekst të krijimit dhe zhvillimit të dramës në vitet e fundit, prof. dr. Nebi Islami konstaton se: *Në këtë periudhë të transicionit dhe të përshtatjes së kushteve të reja, drama ka kërkuar një identitet të ri në përpjekje për gjetjen e mënyrave të pasqyrimin të zhvillimeve të përgjithshme, kështu që, në krijimet që dolën në dritë gjatë kësaj periudhe janë shfaqur prirjet e posaçme, për pasqyrimin e jetës dhe të vetëdijës përmes demistifikimit të dukurive dhe rrjedhave shoqërore të periudhave të caktuara historike në lidhje kauzale me vlimet aktuale*".

3. Lindja e brezit të ri

Përderisa në Shqipëri, në mungesë të një shkolle profesionale për shkrimin e dramës, janë prozatorët, poetët, regjisorët, madje edhe vet aktorët ata që shkruajnë drama, në Kosovë, nga auditorët e Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës po sheh dritën edhe një brez i ri i dramatistëve, të cilët, me tekstet e tyre dramatike

² L. Isaku, *Rilixime II*, Tetovë, 2014, f. 240.

³ Po aty, f. 254.

⁴ B. Lumi, *Dramaturgjia e re e Kosovës* në Revista "Loja", nr. 5, Prishtinë, f. 310.

dita-ditës po i imponohen opinionit vendas dhe më gjerë. Madje këta autorë *pritet ta pasurojnë edhe më, jo vetëm kuadrin tipologjik të letërsisë dramatike, por edhe nivelin e saj artistik, poetikën e saj, sepse një pjesë e madhe e tyre janë në fazën e pjekurisë krijuese kurse një pjesë tjetër, si autorë relativisht të rinj, janë në fazën e kërkimit dhe ndërtimit të identitetit të tyre krijues*⁵.

Disa nga përfaqësuesit e këtij brezi, me rrafshin tematik dhe stilistik të dramave të tyre, e kanë shpërfaqur bindshëm prirjen e tyre drejt formave dhe gjetjeve të reja, me çka mund të thuhet se ata tashmë kanë hapur një shteg të ri në dramaturgjinë kosovare, ndonëse ende jo me kahje dhe terren krejtësisht të përcaktuar, përderisa disa të tjerë, me prirje e sens më konservativ dhe më tradicional, preferojnë të jenë edhe më tutje vazhdimësi e traditës së deritashme letrare.

Aktualisht, emrat më përfaqësues të këtij brezi dramaturgësh janë: Jeton Neziraj, Doruntina Basha, Ag Apolloni, Ilir Gjocaj, Visar Krusha, Zymber Kelmendi, Mentor Haliti, Albatros Rexhaj, Albana Muja, Arta Arifi, Naser Shatrolli etj., dramat e të cilëve, përveç në formë të shkruar, tashmë e kanë bërë jetën e tyre edhe në formën e inskenimeve të ndryshme brenda e, në disa raste, edhe jashtë Kosovës.

Këto individualitete *krijuese falë energjisë, përpjekjes, insistimit, provokimit dhe investimit të tyre, janë duke imponuar një diskurs të ri krijues në botën e vogël të jetës dhe të skenës teatrore të Kosovës*⁶.

Një nga përfaqësuesit më karizmatikë, më kreativë dhe më energjikë të këtij brezi është dramaturgu Jeton Neziraj (1977), autor i mbi 15 dramave, të cilat janë vënë në skenë dhe, në formën e shfaqjeve apo të leximeve skenike, janë paraqitur në Kosovë dhe jashtë saj. Tematika e dramave të tij *‘Liza po fle’, ‘Lufta në kohën e dashurisë’, ‘Darka e fundit’, ‘Qyteti po rritet’, ‘Melodi Amerikane’, ‘Ura’, ‘Enea i plagosur’, ‘Sytë e shkruar’, ‘Shemja e Kullës Ajfel’*, etj. të cilat në rrafshin zhanror lëvizin ndërmjet dramës e tragjikomedisë, është mjaft e gjerë, duke përfshirë luftën, mbijetesën e njerëzve në vitet e pasluftës, pajtimin, mëkatin, dashurinë, religjionin, terrorizmin modern etj.

Jo rastësisht, Jeton Neziraj, sipas regjisorit Bekim Lumi është *autor i një sensibiliteti të veçantë artistik për krijimin e kontrapunkteve, në krijimtarinë e tij artistike është përcaktuar kryesisht për modelin e dramës ‘mozaik’, në të cilën, jo rrallë, e shkuara dhe e tashmja shpërfaqen, megjulohen, zhduken e rishfaqen, ndeshen, refuzohen, përzihen, përqafohen apo bashkëdyzohen me njëra tjetrën si në një përrallë*. Por, kjo ‘përrallë’, edhe atëherë kur për lëndë të parë ka motive, skica apo ngjyrim nga rrëfimet dhe legjendat popullore, falë mjeshtërisë dhe elegancës creative të Nezirajt, përmes kontrapunkteve - zhvendosjeve kohore dhe hapësinore, intonohet dhe orkestrohet me një muzikalitet poetik urban. Në

⁵ B. Rexhaj, *Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore 1948-2008, poetika, tipologjia, periodizimi* (Vëll. II), Faik Konica, Prishtinë, 2009, f. 336.

⁶ B. Lumi, *Dramaturgjia e re e Kosovës* në Revista “Loja”, nr.5, Prishtinë, f. 310.

gjykimin tim, drama “Shembja e Kullës së Ajfelit” është një nga tekstet më të veçanta dhe më provokative në opusin krijues të dramatishtit Jeton Neziraj.

Në tragjikomedinë e Nezirajt linja e dashurisë është boshti tematik që modelohet pastaj varësisht prej situatave që ndërtohen, ndërlikohen dhe zgjidhen mjeshtërisht nga autori. Historia e dashurisë në këtë vepër mund të përkufizohet si e ndaluar për shkak të përkatësisë fetare, e kjo, në kornizat e paragjytimeve historike dhe të atyre ekzistuese, mund të interpretohet si përkatësia e një “bote tjetër”. Në këtë rast, pavarësisht dallimeve paragjyuese në botëkuptime, Hose dhe Ajshja mund të identifikohen edhe si Romeo e Zhulieta të kohës tonë.

Tekstin e Nezirajt “Shembja e Kullës së Ajfelit” e shquan stili dhe diskursi politik, filozofik e psikologjik, gjë që ndjehet dhe artikullohet në gjuhën e personazheve të veprës. Gjuha e personazheve është gjuhë që herë thumbon e herë mëshiron. Ajo herë të bën të qeshshëm me absurditetin e situatave, e herë të qashë me tragjedinë e personazheve. Për kritikun francez David Larre, *vepra e tij dëshmon për një angazhim politik dhe poetik që demonstroi përjetimet, shpeshherë të largëta, të ngjarjeve të tmerrshme që shkaktuan shkatërrimin e ish-Jugosllavisë.*

Një zë i veçantë, me intonim, brishtësi dhe delikatesë të jashtëzakonshme poetike, është Doruntina Basha, e cila po veçohet suksesshëm në fushën e krijimtarisë dramaturgjike, jo vetëm në hapësirën shqiptare por edhe më gjerë.

Dramat e saj, *“Puthja e ujkut”, “Anita, vajza prej kartoni”, “Shpuza dhe thupra”, “Gishti”,* të cilat trajtojnë kryesisht fatet e njerëzve të brishtë, të cilët nuk mund të krijojnë marrëdhënie me ashpërsinë e kësaj bote, janë të shkruara brenda një formati stilistik krejtësisht jokonvencional, me një fluiditet e spontanitet të veçantë gjuhësor, me tema, situata, gjendje, atmosferë, marrëdhënie, veprime e personazhe të pazakonshme, jashtë çdo rendi klishe, gjë që, në kuadër të këtij brezi dramaturgësh, dorëshkrimin e saj e bën të veçantë dhe jashtëserik⁷. Protagonistë të dramave të saj janë gratë e moshuara, vajzat adoleshente, kafshët, njerëzit nga letra e kartoni, gjësendet e shpirtëzuara, të tilla si shpuza e thupra, pastaj tinejxherët, gratë e personave të zhdukur në luftën e fundit në Kosovë etj., apo, thënë me një fjalë, njerëzit të cilëve, për shkak të lëvizjeve të ndryshme politike, sociale e kulturore, u është pamundësuar përfaqësimi i dinjitetshëm. Teksti dramatik “Gishti” është njëri ndër më të veçantit në krijimtarinë dramaturgjike të Doruntina Bashës. Ky tekst në të gjithë rrathët e boshtit tematik prek dhimbjen e madhe për familjarët e zhdukur. Në dramën e Bashës, teksti strukturohet fort dhe besueshëm me skena, situata e gjetje, që e bëjnë dramën të rrjedhë shumë natyrshëm e njerëzishëm. Këtu personazhet flasin me gjuhën e mendjes dhe të shpirtit, dhe në këtë mënyrë autorja i është shmangur suksesshëm frazeologjisë se tepruar dhe artikulimit patetik të emocioneve të personazheve.

Përveç tjerash, drama “Gishti” shquhet për një stil të veçantë dhe për një gjuhë të rrjedhshme, e cila në gojën e personazheve vjen e motivuar mjaftueshëm,

⁷ B. Lumi, *Dramaturgjia e re e Kosovës* në Revista “Loja”, nr. 5, Prishtinë, f. 314.

dhe asesi e stisur dhe e konstruktuar artificialisht. Kështu, figura e gishtit bëhet simbol i shkasit për grindje e përleshje, por njëkohshëm gishti, veçmas atëherë kur prehet me thikë e pikon gjak, shndërrohet në metaforë të një dhimbje që duhet tejkaluar doemos.

Ag Apolloni (1982) është një emër tjetër insistues në dramaturgjinë e re të Kosovës, i cili, në vitin 2010, nën titullin "Drama" ka botuar katër drama: 'Stefani, historia e një koleksionisti të syve', 'Halloween', 'Judita' dhe 'Mat', të cilat përbëjnë një tetralogji sipas modelit antik grek. Këto katër drama përgjithësisht lidhen në bipolaritetin tematik dashuri-vdekje, prandaj edhe autori, në shënimin që ua bën dramave të tij në fillim të librit, e definon veprën e tij si 'tanateros'. Dashuria dhe vdekja, si dy tema kryesore të letërsisë botërore, këtu trajtohen me një stil që kombinon gotikën me postmodernen dhe afron antikën me modernen. Situatat janë të mbushura me konflikte të brendshme dhe të jashtme, ndërsa dialogët i karakterizon elipsa dhe tensioni.

Dramaturgjia e Apollonit veçohet, jo vetëm e shkruar si gjini letrare, por edhe për potencialin e madh inskenues (*teatror*) që kanë këto tekste dramatike.

Një dramatiste e re, jo më pak e rëndësishme është edhe Albana Muja (1988), e cila me dramën e saj të botuar tash së fundmi "Komedi e kuqe" (2015), suksesshëm i është bashkuar gjeneratës së re të shkrimtarëve të dramës në Kosovë. Me këtë tekst ajo ka dëshmuar se se njeh dhe ka përvetësuar mire ligjësitë dhe shkathtësitë e shkrimit dramatik, duke vënë në funksion frytdhënës të gjitha elementet që përmban një vepër dramatike; dialogun veprues, situatat konfliktuale, karakteret e plotat, didaskalitë apo udhëzimet skenike të sakta.

Edhe pse një pjesë e konsiderueshme e dramës shqiptare moderne është mbindërtuar në sferën tematike të periudhës parakombëtare dhe kombëtare, në mbështetje të *reminiscence*, të dëshmiave dhe të kujtesës historike⁸ një gjë e tillë nuk mund të thuhet për veprat dhe autorët e përmendur në këtë punim, të cilët, secili në mënyrën e vet, ku më shumë e ku më pak, kanë shfaqur hapur prirjet dhe tendencën për kultivimin e një dramaturgie bashkëkohore që synon kah trendet bashkëkohore të shkrimit dramatik.

4. Përfundime

Në përfundim, duke e parë në dritën e fakteve gjendjen, pozicionin dhe zhvillimin e teatrit dhe dramës shqipe në vendin tonë, mund të themi se: për mëse 16 vjet pas përfundimit të luftës dramaturgjia e re në Kosovë, me disa përjashtime, nuk ka arritur të largohet nga ndikimi ideor, tematik dhe strukturor i dramaturgisë së traditës, kryesisht asaj të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, prandaj, është e besueshme se qasjet dhe shprehjet e reja ideore, tematike, stilistike në dramaturgjinë bashkëkohore shqipe janë të rralla, dhe lidhen me punën krijuese të fare pak dramatistëve të rinj, kryesisht atyre që i përmenda më lart.

⁸ L. Isaku, *Rilexime II*, Tetovë, 2014, f. 241.

Duke analizuar dhe vlerësuar rrjedhat aktuale të zhvillimeve teatrore dhe dramaturgjike në vendin tonë, shkrimtari dhe kritiku Musa Ramadani shprehet: “Tani teatri ynë dhe dramaturgjia jonë është në kërkim. Madje, kështu ka qenë përherë. Në grishje të identiteti të vet”.

Përderisa albanologu i shquar Robert Elsie shprehet se: “*Drama bashkëkohore në Shqipëri ende mbetet për t'u krijuar nga hapat e parë të saj, ndërsa jeta e shqiptarëve është plot me drama të mëdha*”, e njëjta gjë vlen edhe për Kosovën si një vend me dramaturgji të vogël por me plot drama të mëdha.

BIBLIOGRAFI

- A. Gashi, *Rrëfimet e maestros*, Multimedia, Prishtinë, 2014.
B. Rexhaj, *Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore 1948-2008, poetika, tipologjia, periodizimi*. (Vëll. I dhe II), Faik Konica, Prishtinë, 2009.
Grup Autorësh, *Teatri dhe Nacionalizmi*, Multimedia, Prishtinë, 2011.
L. Isaku, *Rilexime II*, botim i autores, Tetovë, 2014.
N. Islami, *Historia dhe poetika e dramës shqiptare (1886-1996)*, ARTC, Prishtinë, 2003.
R. Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Tiranë-Pejë, 1997.
Revista “Loja”, nr. 5. Prishtinë, 2011 (f. 310-318).